

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXV, nr. 8172  
E enjte, 30 tetor 2025  
Çmimi 0.50 €

## Siria njeh Kosovën

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## PRESIDENTJA DO T'U KËRKOJË PARTIVE KOMPROMIS, PASI KOSOVA RREZIKON TË MBETET PA BUXHET

FAQE 4



Presidentja Vjosa Osmani do ta theksojë rëndësinë e miratimit të buxhetit të Kosovës si dhe miratimin e Planit të Rritjes së BE-së gjatë bisedimeve të ardhshme me partitë politike, tha këshilltari i saj për medie, Bekim Kupina, pasi shoqëria civile në vend i bëri thirrje asaj t'i bashkojë partitë për ta miratuar buxhetin e ri. Ai shtoi se Osmani "do t'i inkurajojë" partitë politike të bashkëpunojnë për ta shmangur çdo bllokadë që mund të ndikojë negativisht në mirëqenien e qytetarëve dhe në funksionimin e institucioneve të Kosovës

OVLUÇK PROTESTON MË 16 NËNTOR PARA ASAMBLESË PARLAMENTARE TË KËSHILLIT TË EVROPËS NË STRASBURG F. 3



KURTI NË PARIS THEKSON NGRITJEN E KAPACITETEVE TË FSK-së NË BASHKËPUNIMIN ME PARTNERËT NDËRKOMBËTARË F. 5



SHBA-ja TËRHEQ DISA TRUPA NGA RUMANIA F. 2

KOSOVA KËRKON AGJENDË TË PËRBASHKËT ME BELGJIKËN NË FUSHËN E MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE F. 3

GJYKATA SUPREME LË NË FUQI NDALIMIN E MBULESËS ISLAME NË SHKOLLA PUBLIKE F. 6

### EKONOMI



KRYETARI I AKB-SË: MOSMIRATIMI I BUXHETIT MUND TA ÇOJË VENDIN DREJT FALIMENTIMIT F. 6

GUVERNATORI ISMAILI THEKSON ANGAZHIMIN E BQK-SË PËR MODERNIZIMIN E SISTEMIT TË PAGESAVE NË KOSOVË F. 8

### SPORT



PRISHTINA BIE NË LLAP, FITOJNË DRENICA DHE FERIZAJ F. 11

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mod: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Siria njeh Kosovën

**RIAD, 29 TETOR** - Siria ka njohur Republikën e Kosovës. Lajmin e ka dhënë presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e cila ndodhet për vizitë zyrtare në Arabinë Saudite. Ajo ka thënë se kjo njohje ka ardhur falë mbështetjes së Arabisë Saudite. “Me mbështetjen e Lartësisë së tij Mbretërore, Princit të Kurorës së Arabisë Saudite, Muhammed bin Salman Al Saud, sot në Riad

arritëm marrëveshjen nëpërmjet së cilës Republika Arabe e Sirisë njeh Republikën e Kosovës. Falënderoj presidentin Al Sharaa për vendimin për njohje të Kosovës si dhe për mbështetjen e tij për popullin tonë. Populli i Kosovës dhe ai i Sirisë kanë vuajtur e sakrifikuar shumë për ta arritur lirinë. Prandaj kjo njohje e ndërsjellë sot nuk

është vetëm e sovranitetit shtetëror, por edhe njohje e sakrificës së shumë brezave për të jetuar të lirë. Falënderoj Princin e Kurorës së Mbretërisë së Arabisë Saudite që e bëri të mundshëm këtë akt historik ndërmjet dy shteteve tona. Tani Kosova njihet nga 120 shtete. Republika jonë po ecën përpara dhe nuk ka asgjë që mund ta ndalë!”, ka shkruar Osmani në “Facebook”.



## SHBA-JA TËRHEQ DISA TRUPA NGA RUMANIA

**WASHINGTON, 29 TETOR** - Shtetet e Bashkuara kanë tërhequr afër 1 000 ushtarë dhe përafërsisht po aq kanë lënë të stacionuar në Rumani, bënë me dije zyrtarët në Bukuresht, duke theksuar se për këtë vendim u njoftuan në fillim të javës. Ushtria amerikane tha se ky vendim nuk duhet të kuptohet si “tërheqje” e Uashingtonit nga Evropa e as “si sinjal për ulje të angazhimit ndaj NATO-s dhe Nenit 5”. “Përkundrazi, ky është një sinjal pozitiv i rritjes së kapaciteteve dhe përgjegjësisë evropiane”, tha ushtria më 29 tetor, duke shtuar se ripozicionimi i forcave nuk do ta ndryshojë mjedisin e sigurisë në Evropë.

Uashingtoni tha se vazhdon të ketë prani të fortë në mbarë Evropën. Ndërkaq, ministri rumun i Mbrojtjes, Ionut Mosteanu, në një konferencë për medie, tha se në shtetin e tij do të mbeten “afër 900-1 000 ushtarë amerikanë, pak më shumë sesa ishin në fillim të luftës në Ukrainë”. Paraprakisht, mëngjesin e 29 tetorit Ministria e Mbrojtjes në Rumani bëri publik njoftimin për “tërheqje të pjesshme” të trupave amerikane nga Rumania. “Forcat amerikane në bazat Deveselu dhe Campia Turzii mbeten të pandryshuara. Afër 1 000 mbeten në Deveselu, Campia Turzii dhe Mihail Kogalniceanu. Nuk është ndonjë katastrofë, është një vendim i aleatëve tanë. Ata mbeten në këto tri pika”, tha ai. Ministri i Mbrojtjes theksoi se vende të tjera të NATO-s, veçanërisht Franca, kanë aktualisht rreth 2 500 ushtarë në territorin e Rumanisë dhe se, pas stërvitjes “Dacian Fall” që po zhvillohet në këtë periudhë, në këtë shtet gjithsej do të mbeten “afër 3 500” trupa. “Mjaftojnë për

atë që na duhet”, shtoi Mosteanu, duke theksuar se “është e paarsyeshme të pritët që ushtritë e mëdha aleate të jenë të pranishme në territorin e Rumanisë”. “Jemi në kontakt me të gjithë aleatët dhe do të shohim në të ardhmen nëse do të vijmë më shumë ushtarë”, u përgjigj ai në pyetjet e gazetarëve për këtë çështje. Udhëheqësi i mbrojtjes në Rumani u shpreh se vendimi për tërheqjen e afër 1 000 ushtarëve amerikanë “është pjesë e një strategjie më të gjerë të ShBA-së” që përqendrohet në Indo-Paqësor, duke shtuar se Rumania u njoftua zyrtarisht për vendimin e Uashingtonit më 27 tetor. “Nuk bëhet fjalë për një tërheqje amerikane, por për ndalimin e rotacionit të një brigade që përbëhej nga elementë në disa shtete të NATO-s, në Bullgari, Rumani, Sllovaki dhe Hungari. Rreth 1 000 ushtarë amerikanë do të vazhdojnë të mbesin në Rumani, duke kontribuar në pengimin e çdo kërcënimi”, tha ai. Mosteanu shtoi se vendimi u mor gjithashtu për shkak të forcimit të pranisë ushtarake të aleatëve të NATO-s në krahun lindor. “Kapacitetet strategjike [në Rumani] mbeten të pandryshuara. Sistemi i mbrojtjes antiraketore në Deveselu ruan funksionalitetin e tij të plotë. Baza ajrore në Campia Turzii vazhdon të jetë një pikë kyçe për operacionet ajrore dhe bashkëpunimin aleat. Baza Mihail Kogalniceanu vazhdon të zhvillohet. Flamuri amerikan do të vazhdojë të jetë në të gjitha këto tri pika”, përsëriti Mosteanu. “Në Kogalniceanu do të mbetet ende një grup luftarak ajror, ashtu siç ka qenë në fakt para shpërthimit të konfliktit në Ukrainë”. Mosteanu shtoi se “forca kryesore për mbrojtjen e sigurisë së



Rumanisë dhe të çdo qytetari është Ushtria Rumune” dhe se modernizimi i saj duhet të jetë prioriteti kryesor i shtetit rumun. “Insistoj për këtë sepse e ardhmja duhet të jetë në duart e secilit prej nesh”. I pyetur nëse vendimi i ShBA-së ndikon në sigurinë e Rumanisë dhe nëse mund të ketë më shumë incidente apo provokime ruse në kufijtë e vendit, Mosteanu tha se jo. Po ashtu, ministri rumun tha se Artikulli 5 i NATO-s nuk do të preket nga ky vendim i Uashingtonit, partnerit strategjik të Bukureshtit. Ai shtoi se nisja e pushtimit rus të Ukrainës ishte “një sinjal alarmi për të gjithë Evropën, e cila deri atëherë ishte mbështetur shumë në partnerin amerikan”. “Por, që nga atëherë, në tre vjet e gjysmë, Evropa ka kuptuar se duhet t’i japë më shumë vëmendje mbrojtjes së secilit shtet dhe pajisjes së çdo ushtrie. Janë bërë investime, janë realizuar programe, është forcuar përgjigjja e shteteve të tjera aleate, sidomos në krahun lindor”. Ionut Mosteanu gjithashtu tha se nuk sheh ndonjë regres në lidhje me këtë tërheqje ushtarake, edhe pse lufta e Rusisë në Ukrainë - një vend me të cilin Rumania ndan një kufi tokësor prej gati 650

kilometrash - vazhdon, pavarësisht prej përpjekjeve të administratës Trump për ta arritur paqen. I pyetur nëse strategjia kombëtare për mbrojtje do të modifikohet ose nëse do të rikthehet shërbimi i detyrueshëm ushtarak, Mosteanu dha përgjigje negative për të dyja çështjet. “E kemi projektin për shërbim vullnetar ushtarak dhe do t’i rinovojmë rezervat. Nuk diskutohet çështja e shërbimit të detyrueshëm. Rumania ka një ushtri të mirë, një ushtri e mirë varet nga kapacitetet që ka. Duhet të investojmë më tej, t’i rrisim pajisjet dhe përgatitjen e ushtarëve tanë”, theksoi ai. Ndërkaq, ambasadori amerikan në NATO, Matthew Whitaker, shkroi në X se aleatët e NATO-s, sikurse Rumania, kanë treguar se kanë ngritur aftësitë dhe përgjegjësitë. Sipas tij, në 20 e më shumë vjet Bukureshti vazhdimisht ka pasur partneritet me ShBA-në për t’i përmbushur objektivat e përbashkëta të mbrojtjes. “Ky partneritet vazhdon të jetë më i fuqishëm se kurrë. ShBA-ja vazhdon të jetë e përkushtuar ndaj Rumanisë - një aleate e besueshme e NATO-s, partnere strategjike dhe një forcë

shtytëse për sigurinë në Evropë”, shkroi ai. Një zyrtar i NATO-s tha për “Radion Evropa e Lirë” se aleanca ishte njoftuar paraprakisht nga ShBA-ja lidhur me përshtatjen e pozicionit të forcave amerikane, duke shtuar se aleanca dhe Uashingtoni janë në kontakt të ngushtë për këtë çështje. “Edhe me këtë ndryshim, prania e forcave amerikane në Evropë është më e madhja për shumë vite dhe ka më shumë trupa amerikane në kontinent që para vitit 2022”, tha zyrtari i NATO-s. “NATO dhe autoritetet amerikane janë në kontakt të ngushtë lidhur me pranimë e përgjithshme të ushtarëve, për t’u siguruar që NATO të ketë kapacitetet e nevojshme për parandalim dhe mbrojtje dhe autoritetet amerikane e kanë informuar paraprakisht NATO-n për këto ndryshime”, shtoi ai. NATO tha se përkushtimi i ShBA-së ndaj aleancës ushtarake përfundimor është i qartë dhe se administrata e presidentit Donald Trump e ka përsëritur disa herë këtë përkushtim. Ministria e Mbrojtjes e Rumanisë është “informuar për rishikimin e një pjese të trupave amerikane të dislokua në krahun lindor të NATO-s si pjesë e procesit të rivlerësimit të pozicionit global të forcave ushtarake të ShBA-së”, u tha në njoftimin e publikuar mëngjesin e 29 tetorit. “Mes elementeve të brigadës që do t’i ndalojnë rotacionet në Evropë përmenden edhe forcat e destinuara për Rumaninë, të vendosura në bazën Mihail Kogalniceanu”, tha Ministria rumune e Mbrojtjes. Kjo ministri theksoi se “vendimi ishte i pritshëm, pasi Rumania ka qenë në kontakt të vazhdueshëm me partnerin strategjik amerikan”.

## ShBA-ja e heq Millorad Dodikun nga lista e zezë

**SARAJEVË, 29 TETOR** - Shtetet e Bashkuara i kanë hequr nga lista e sanksioneve ish-liderin e serbëve të Bosnjës, Millorad Dodikun, si dhe anëtarin e Presidencës së Bosnjës, Zheleka

Cvijanoviq, njoftoi Departamenti i Thesarit të mërkurën. Përveç tyre, nga lista e zezë janë hequr dhe anëtarët e familjes së Dodikut, kompanitë e tyre dhe

bashkëpunëtorët e ngushtë. Dodik, presidenti i Aleancës së Social Demokratëve të Pavarur, ishte sanksionuar dy herë për shkak shkeljes së Marrëveshjes së Dejtonit për Paqe.

Përveç tyre, 48 individë dhe subjekte juridike, që më parë ishin sanksionuar sipas Programit të Sanksioneve për Ballkanin Perëndimor, u hoqën nga lista e sanksioneve.



# OVLUÇK PROTESTON MË 16 NËNTOR PARA ASAMBLESË PARLAMENTARE TË KËSHILLIT TË EVROPËS NË STRASBURG

PRISHTINË, 29 TETOR - Më 16 nëntor organizatat e dala nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës do të mbajnë protestë para Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës në Strasburg. "Shoqata e dala nga lufta kanë vendosur që protestën e radhës ta organizojnë më 16 nëntor në ora 13:00 para Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës në Strasburg", ka thënë kryetari i OVLUÇK-së, Hysni Gucati, në një konferencë për

medie. Sa i përket një proteste në Maqedoninë e Veriut, Gucati ka thënë se nuk do të mbahet para se të përfundojë procesi zgjedhor, ai i balotazhit atje. Ndërsa në Preshevë veteranët nuk do të mbajnë asnjë protestë për shkak që, siç tha Gucati, situatës aty dhe bastisjet që xhandarmëria serbe herë pas here po bën të shqiptarët. "Në Maqedoni për momentin jo, sepse janë duke u mbajtur zgjedhjet dhe nuk duam të shkojmë atje për momentin dhe

të mbajmë protestë për arsye se mund të dalë situata prej dore, mund të na provokojë ndokush. Pa u kryer balotazhi në Maqedoni nuk mendojnë të organizojmë protestë. Për Preshevë jo, sepse situata është e nxehtë dhe i shihni bastisjet që po bëhen te pjesëtarët e luftës ku po i bastis Serbia çdo ditë. Shokët tanë mund të organizojnë, por ne e kemi edhe të ndaluar për të shkuar. Ata po i arrestojnë qytetarët e Kosovës në kufi", ka thënë Gucati.



## BARDHYL MAHMUTI: NË MAQEDONINË E VERIUT RREZIKOHEN TË DREJTAT E SHQIPTARËVE



PRISHTINË, 29 TETOR - Veprimtari Bardhyl Mahmuti ka thënë se në Maqedoninë e Veriut po rrezikohen të drejtat e shqiptarëve. Ai ka thënë se është koha të ndahet egjra nga gruri, duke theksuar se në rastin kur politika e VMRO-së shpërfaq qartë orientimin për t'i shkatërruar të drejtat e shqiptarëve autoktonë në Maqedoninë e Veriut dhe, sipas tij, të gjithë ata që mbështesin këtë orientim politik, bëhen pjesë e strategjisë që godet qenien tonë kombëtare. "E drejta për t'i ndryshuar

pikëpamjet politike, religjioze madje edhe identitetin kombëtar, është e drejtë e pakontestueshme që çdo njëri duhet ta respektojë. Mirëpo, në rastet kur nëpërmjet votës së tij përcakton edhe fatin e atyre që mendojnë ndryshe, çështja tejkalon të drejtën e shprehjes së lirë të mendimit apo të ndjenjës së përkatësisë! Në rastin kur politika e VMRO-së shpërfaq qartë orientimin për të shkatërruar të drejtat e shqiptarëve autoktonë në Maqedoninë e Veriut, të gjithë ata që mbështesin këtë orientim

politik, bëhen pjesë e strategjisë që godet qenien tonë kombëtare. Prandaj pa marrë parasysh lidhjet e mia familjare apo shoqërore, çdo person që mbështet apo voton për strategjinë antishqiptare, të tërhiqet nga lista e miqve të mi në FB dhe nga jeta ime private", ka thënë Mahmuti. Sipas tij, në kontekstin aktual kur të drejtat elementare të shqiptarëve autoktonë në Maqedoninë e Veriut janë të rrezikuara seriozisht, është detyrë e çdo atdhetari të jetë i prerë: Është koha të ndahet egjra nga gruri.

## KOSOVA KËRKON AGJENDË TË PËRBASHKËT ME BELGJIKËN NË FUSHËN E MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE

PRISHTINË, 29 TETOR - Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Ilir Muçaj, gjatë një takimi me delegacionin belg të kryesuar nga drejtoresha e përgjithshme për bashkëpunimin dypalësh, Birgit Stevens, ka kërkuar mundësinë e zhvillimit të një agjende të përbashkët në fushën e marrëveshjeve ndërkombëtare. Takimi është bërë me dije përmes një komunikate nga MPJD. "Sekretari Muçaj, në emër të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, shprehu mirënjohjen për bashkëpunimin



dhe mbështetjen e palëkundur që Mbretëria e Belgjikës ka ofruar për Republikën e Kosovës në të gjitha fazat e konsolidimit të saj. Në këtë frymë bashkëpunimi, u zhvilluan konsultimet politike ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Belgjikës, ku u diskutua për marrëdhëniet dypalëshe, forcimin e mëtejshëm të tyre, si dhe mundësitë për zhvillimin e një agjende të përbashkët në fushën e marrëveshjeve ndërkombëtare. Të dyja palët ritheksuan rëndësinë e mbajtjes së këtyre konsultimeve politike si një mekanizëm

thelbësor për thellimin e bashkëpunimit dhe për identifikimin e mundësive që kontribuojnë në koordinimin në çështje me interes të përbashkët, përfshirë edhe rritjen e bashkëpunimit ekonomik. Konsultimet politike ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Belgjikës dëshmojnë për partneritetin e qëndrueshëm ndërmjet dy vendeve mike, që vazhdojnë të forcohen përmes dialogut të hapur dhe bashkëpunimit konkret në fusha me interes të përbashkët", ka njoftuar MPJD.

## Kadetët e FSK-së realizuan me sukses garën "Triumfi Dardan 2025"

PRISHTINË, 29 TETOR - Kadetët e Qendrës për Studime Universitare të FSK-së përfunduan me sukses patrullën "Triumfi Dardan 2025", një garë ushtarake që zhvillohet çdo vit në kushte të vështira terreni dhe që teston aftësitë fizike, mendore dhe taktike të pjesëmarrësve. Në këtë patrullë kanë marrë pjesë gjithsej 27 kadetë të ndarë në tre skuadra ku një

vëmendje e veçantë iu kushtua pjesëmarrjes së skuadrës nga Akademia Ushtarake e Turqisë. Pjesëmarrja e tyre përbën një shembull të shkëlqyer të bashkëpunimit ushtarak në mes të Kosovës dhe Turqisë, duke forcuar miqësinë dhe shkëmbimin e përvojave profesionale ndërmjet dy ushtrive mike. Ky aktivitet jo vetëm që forcoi

lidhjet ushtarake ndërmjet institucioneve arsimore të dy vendeve, por dëshmoi se sfidat e përbashkëta ndërtojnë miqësi të qëndrueshme dhe profesionalizëm të përbashkët. Në përfundim të patrullës, të gjithë kadetët, përfshirë ata nga Akademia Ushtarake e Turqisë, u vlerësuan për përkushtimin, vendosmërinë dhe shpirtin luftarak që treguan gjatë gjithë garës.





# PRESIDENTJA DO T'U KËRKOJË PARTIVE KOMPROMIS, PASI KOSOVA RREZIKON TË MBETET PA BUXHET

Presidentja Vjosa Osmani do ta theksojë rëndësinë e miratimit të buxhetit të Kosovës si dhe miratimin e Planit të Rritjes së BE-së gjatë bisedimeve të ardhshme me partitë politike, tha këshilltari i saj për medie, Bekim Kupina, pasi shoqëria civile në vend i bëri thirrje asaj t'i bashkojë partitë për ta miratuar buxhetin e ri. Ai shtoi se Osmani “do t'i inkurajojë” partitë politike të bashkëpunojnë për ta shmangur çdo bllokadë që mund të ndikojë negativisht në mirëqenien e qytetarëve dhe në funksionimin e institucioneve të Kosovës

Prishtinë, 29 tetor - Presidentja Vjosa Osmani do të kërkojë miratimin e buxhetit të Kosovës dhe Planit të Rritjes së BE-së në konsultimet me partitë politike. Mungesa e buxhetit të ri kërcënon pagesat për mësimdhënës, mjekë, administratë publike dhe projekte publike në Kosovë. Ekspertët ligjorë thonë se qeveria në detyrë nuk ka kompetenca për ta propozuar buxhetin për legjislaturën e re. Presidentja Vjosa Osmani do ta theksojë rëndësinë e miratimit të buxhetit të Kosovës si dhe

miratimin e Planit të Rritjes së BE-së gjatë bisedimeve të ardhshme me partitë politike, tha për “Radion Evropa e Lirë” këshilltari i saj për medie, Bekim Kupina, pasi shoqëria civile në vend i bëri thirrje asaj t'i bashkojë partitë për ta miratuar buxhetin e ri. “Presidentja do të bëjë thirrje për një kompromis politik nëpërmjet të cilit do të garantohet interesi i Kosovës dhe i qytetarëve të saj, si dhe të sigurohet rruga përpara për avancimin e vendit”, tha Kupina të martën.

Ai shtoi se Osmani “do t'i inkurajojë” partitë politike të bashkëpunojnë për ta shmangur çdo bllokadë që mund të ndikojë negativisht në mirëqenien e qytetarëve dhe në funksionimin e institucioneve të Kosovës.

Osmani pritet t'i thërrasë për konsultime partitë politike së shpejti, pasi të dielën mandatarin e parë për formimin e qeverisë së re, Albin Kurti i Lëvizjes Vetëvendosje, dështoi t'i fitojë votat e nevojshme për një mandat të tretë.

Kosova e bëri Kuvendin e ri muaj më parë, por dështimi javën e kaluar për ta formuar një qeveri të re, ka rritur rrezikun që vendi të hyjë në vitin 2026 pa buxhet.

Në një letër drejtuar Osmanit, 21 organizata të shoqërisë civile thanë se mungesa e buxhetit të ri do t'i paralizonte pagesat për pagat e mësimdhënësve, mjekëve, administratës publike, për transferet sociale të qindra mijëra qytetarëve të Kosovës, realizimin e punëve publike dhe më shumë. “E ardhmja financiare e vendit dhe mirëqenia e qytetarëve nuk duhet të bëhen peng i bllokadave politike. Ne besojmë

se përvoja, autoriteti dhe roli juaj unifikues si presidente mund të jenë përcaktues për të shmangur një krizë që do të prekte shumë familje në Kosovë”, thuhet në letër.

Këto organizata i propozuan presidentes, siç thanë, disa “rrugë të mundshme ligjore dhe të zbatueshme”. Ato kërkojnë që qeveria në detyrë ta dorëzojë në Kuvend Projektligjin e Buxhetit për vitin 2026, apo Kuvendi i tanishëm të paktën ta votojë një zgjatje të buxhetit të tanishëm deri në fund të muajit mars 2026.

Ato, gjithashtu, kërkojnë ratifikimin e Marrëveshjes me Bashkimin Evropian për Planin e Rritjes, Marrëveshjes së Facilitetit dhe Marrëveshjes së Huas.

Plani i Rritjes përmban një paketë prej 6 miliardë eurosh për ta përkrahur përafrimin e ekonomive të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor me standardet evropiane. Nga kjo paketë, Kosova mund të përfitojë mbi 880 milionë euro, por mosratifikimi i marrëveshjes me bllokun ka bërë që ajo të mos jetë në gjendje ta marrë asnjë qindarkë ende nga kjo shumë.

**Por, a mund një qeveri në detyrë të bëjë buxhet të ri?**

Shumë ekspertë ligjorë vlerësojnë se qeveria në detyrë nuk mund dhe nuk ka kompetenca për të propozuar buxhet për miratim në Kuvendin e ri të vendit.

Në një intervistë për “Radion Evropa e Lirë” të hënën, eksperti i financave, Haki Shatri, tha se vetëm një qeveri me kompetenca të plota mund të ndërmarrë nisma për ndryshimin e Ligjit për Buxhetin, apo për vazhdimin e ndarjeve buxhetore edhe për muajt e parë të 2026-s. “Nëse nuk gjendet ndonjë zgjidhje që të funksionalizohet një e dymbëdhjeta e buxhetit në janar, edhe tërmet të ketë, nuk guxon askush të ndërmarrë asgjë”, tha ai.

Ish-ministri i Ekonomisë dhe Financave shtoi se pa një qeveri të re në janar s'do të ketë para as për ushtrinë e policinë. Albert Krasniqi nga organizata “Demokraci Plus” shkroi të martën në “Facebook” se qeveria në detyrë - e zgjedhur nga legjislatura paraprake - nuk

# KURTI NË PARIS THEKSON NGRITJEN E KAPACITETEVE TË FSK-së NË BASHKËPUNIMIN ME PARTNERËT NDËRKOMBËTARË

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

**PARIS, 29 TETOR** - Në kryeqytetin e Francës, në Paris, kryeministri në detyrë, Albin Kurti, mori pjesë në diskutimin e organizuar nga Instituti i mirënjohur francez, Jacques Delors. Aty u mirëprit nga drejtoresha e Institutit, Sylvie Mattelly.

Tema kryesore e diskutimit ishte situata gjeopolitike në Evropë dhe ndikimi i Ballkanit Perëndimor. Tema të tjera të diskutimit ishin mbrojtja, të drejtat e njeriut, përfshirë ato të pakicave, si dhe zhvillimet e

fundit në vend.

I pranishëm në këtë tryezë ishte edhe i Dërguari i Posaçëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Francës për Ballkanin Perëndimor, René Troccaz.

Kryeministri shprehu mirënjohjen e tij për ftesën e Institutit Jacques Delors për të qenë pjesë e këtij diskutimi. Në fjalën hyrëse të tij, ai theksoi se po jetojmë në një kohë kur Evropa është e begatë, në të njëjtën kohë thellësisht e sfiduar, duke shtuar se aftësia jonë për të planifikuar në terma afatgjatë vazhdimisht po vihet në hije nga realitete të menjëhershme gjeopolitike. Për

dekada jemi udhëhequr nga dëshira për homeostazë, por ky më nuk është realiteti ynë, tha më tej Kurti. “Sistemet që lulëzojnë, qofshin ato institucione, organizata apo shoqëri, evoluojnë përmes cikleve të rendit, çrregullimit dhe rirregullimit dhe për Evropën, ky ekuilibër i ri kërkon një qëndrim të qartë kundër autoritarizmit dhe përfshirje e qartë e atyre vendeve që mbështesin demokracinë”, u shpreh kryeministri.

Duke folur për Kosovën, zhvillimet aktuale dhe përparimin e viteve të fundit,

kryeministri Kurti theksoi se që prej shpalljes së pavarësisë në vitin 2008 me mbështetjen ndërkombëtare, vendi ynë ka zhvilluar institucione të forta demokratike, ndërkaj gjatë këtij mandati qeveritar Kosova ka luftuar korrupsionin dhe ka shënuar rritje të qëndrueshme ekonomike. Ai veçoi lajmet se në muajin korrik të këtij viti, Fondi Ndërkombëtar Monetar dhe Banka Botërore hoqën zyrtarisht Kosovën nga lista e vendeve të brishta dhe të prekura nga konflikti duke u bazuar në përparimin institucional dhe ekonomik të vendit siç

reflektohen edhe në rënien e ndjeshme të papunësisë nga afër 26 % në më pak se 11 %.

Më tej, kryeministri u shpreh se vendi ka paraqitur dhe zbatuar politika përparimtare sociale që përmirësojnë jetesën dhe mirëqenien e qytetarëve; nga bërja e arsimit të lartë publik falas dhe ndarja e shtesave për lehona e fëmijë, te skemat e punësimit të rinjve dhe pensione më të larta, teksa Kosova po përgatitet që t'i mirëpresë Lojërat Mesdhetare 2030 në kuadër të cilave po bëhen e do të bëhen investimet më të mëdha në infrastrukturën sportive.

Sa i përket kësaj të fundit, kryeministri falënderoi Agjencinë Franceze për Zhvillim (AFD) dhe përfaqësuesit e saj që ishin aty të pranishëm për mbështetjen dhe bashkëpunimin me institucionet e vendit tonë.

Gjatë diskutimit u trajtua edhe tema e sigurisë dhe mbrojtjes, me ç'rast kryeministri nënvizoi vëmendjen që qeveria që ai drejton i ka dhënë mbrojtjes përmes rritjes së buxhetit dhe ngritjes së kapaciteteve të Forcës së Sigurisë së Kosovës në bashkëpunimin me partnerët tanë ndërkombëtarë, duke theksuar se mbrojtja e demokracisë është e pandashme dhe e pandalshme.

Në këtë tryezë kryeministri ishte i shoqëruar nga zëvendësministri në detyrë i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Kreshnik Ahmeti, dhe ambasadori i Kosovës në Francë, Mehdi Halimi.

## Gjykata Supreme refuzon ankesën e AAK-së për rivotim në Junik

**PRISHTINË, 29 TETOR** - Gjykata Supreme e Kosovës ka refuzuar të merrkurën si të pathemeltë ankesën e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës lidhur me procesin e votimit në komunën e Junikut, duke lënë në fuqi vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa.

AAK-ja kishte kërkuar nga Gjykata të shpallëshin të paligjshme zgjedhjet komunale të mbajtura më 12 tetor 2025 në Junik, të urdhërohej pastrimi i listave të

votuesve dhe të përsëritej votimi, me arsyetimin se një numër personash ishin regjistruar si banorë të kësaj komune vetëm pak muaj para zgjedhjeve.

Pas shqyrtimit të ankesës, Kolegji i Gjykatës Supreme konstatoi se pretendimet e paraqitura nga subjekti politik nuk përbëjnë shkelje të tilla që lidhen me procesin e ditës së votimit dhe për këtë arsye nuk mund të çojnë në anulimin e rezultatit zgjedhor.

Në aktgjykim thuhet se çështjet

që lidhen me ndryshimin e vendbanimeve dhe regjistrimin e votuesve në periudhën parazgjedhore mund të jenë objekt hetimi nga Prokuroria, nëse ekzistojnë elemente të veprës penale, por nuk janë kompetencë e PZAP-it apo e Gjykatës Supreme në kuadër të kontestimeve zgjedhore.

Me këtë vendim, Gjykata Supreme e Kosovës ka konfirmuar përfundimisht vlefshmërinë e rezultatit të zgjedhjeve komunale të 12 tetorit në komunën e Junikut.



mund ta propozojë Projektligjin për Buxhetin vjetor për legjislaturën e re. “Kuvendi, që ende nuk ka zgjedhur qeverinë e re, nuk mund të miratojë ligje pa pasur qeverinë e vet që t'i zbatojë. Rregullorja e Kuvendit parashikon që projektbuxheti të shqyrtohet nëpër komisione parlamentare - komisione që ende nuk janë themeluar”, shkroi

ai.

Ai tha se duhet të bëhet i qartë dallimi mes qeverisë në dorëheqje dhe qeverisë në detyrë, duke shpjeguar se qeveria në dorëheqje është ajo që gjatë mandatit të saj, pas dorëheqjes apo shkarkimit të kryeministrit, vazhdon të ushtrojë funksionet deri në formimin e qeverisë së re, duke pasur ende Kuvend

funksional, komisione të themeluara dhe kanale komunikimi qeveri - Kuvend.

Ndërsa, sipas tij, qeveria në detyrë është qeveri e zgjedhur nga legjislatura paraprake, që nuk ka lidhje institucionale me legjislaturën e re të dalë nga zgjedhjet. “Prandaj, sipas Ligjit për Qeverinë, qeveria në dorëheqje mund ta propozojë

Projektligjin për Buxhetin, ndërsa kjo e drejtë nuk i njihet qeverisë në detyrë”, shtoi ai.

Gëzim Shala nga Instituti i Kosovës për Drejtësi shkroi në “Facebook” të hënën se qeveria në detyrë nuk ka të drejtë ta propozojë buxhetin, as Kuvendi nuk ka të drejtë ta votojë propozimin e buxhetit të kësaj qeverie në detyrë.

“Qeveria në dorëheqje i referohet një qeverie që është zgjedhur nga një legjislaturë e caktuar, e që vazhdon punën deri në momentin e zgjedhjes së qeverisë së re, dhe jo në rastet kur qeverisë i ka përfunduar mandati. Në rastin konkret, qeveria në detyrë nuk është zgjedhur nga kjo legjislaturë dhe nuk i takon asaj”, shkroi ai.

# GJYKATA SUPREME LË NË FUQI NDALIMIN E MBULESËS ISLAME NË SHKOLLA PUBLIKE

PRISHTINË, 29 TETOR - Kolegji i Gjykatës Supreme e ka refuzuar të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses: Rrjeti i Femrave për Zhvillim Profesional "Arrita", e paraqitur kundër të paditurës: Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), me të cilën ka kërkuar që të shpallet i paligjshëm dhe të shfuqizohet neni 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.13 i Udhëzimit Administrativ nr. 06/2014 (MASHT) Kodi i Mirësjelljes dhe Masat Disiplinore për Nxënës të Shkollave të Mesme të Larta. Paditësja pretendon se me Udhëzimin Administrativ nr. 06/2014, që është një akt administrativ i përgjithshëm, nuk mund të ndalohet ushtrimi i të drejtave dhe lirive kushtetuese të vajzave që mbajnë shaminë e kokës (mbulesën islame). "E njëjta ka theksuar se me neni 55.1 të Kushtetutës, saktësohet qartë se 'të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj', duke shtuar se në katër vitet e fundit kanë pranuar ankesa të shumta nga vajzat që janë përjashtuar nga shkollat publike ose të cilave u është pezulluar vijimi i rregullt i procesit mësimor për shkak të bartjes së shamisë në kokë", thuhet në njoftimin e Supremes. Më tutje, thuhet se Gjykata Supreme e Kosovës ka shqyrtuar me kujdes bazën ligjore të aktit nënligjor normativ të

kontestuar, përkatësisht Udhëzimit Administrativ nr. 06/2014 dhe ka vlerësuar se dispozita nga neni 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.13, gjen mbështetje në Ligjin nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në Ligjin nr. 04/L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional. "Nga këto dispozita rezulton se Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ka autorizim të qartë ligjor për të përcaktuar rregulla për sjelljen e nxënësve, përfshirë edhe rregullat për veshjen - uniformën. Rrjedhimisht, akti nënligjor është në përputhje me autorizimin e shprehur ligjor të dhënë nga ligjvënësi. Përcaktimi sikurse në aktin e kontestuar, me të cilin ndalohet bartja e uniformës fetare në shkolla, gjen mbështetje në një akt më të lartë ligjor për nga fuqia hierarkike, andaj si i tillë nuk mund të shfuqizohet", vijon njoftimi. Gjykata është kufizuar në arsyetimin e pretendimeve, përkitazi me nenin 55, paragrafin 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përkatësisht për kufizimin e lirisë së besimit dhe fesë, si një ndër të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Ndërlidhur me këtë, Gjykata rikujton se Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, me aktvendimin nr. KI 36/11, të



datës 30 shtator 2011, në interpretim të drejtave dhe lirive themelore në pajtim me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj), në pikën 76 të aktvendimit të saj ka theksuar se: liria fetare është kryesisht një çështje e ndërgjegjes individuale dhe përfshin edhe manifestimin e fesë në mënyrë private dhe publike, por nuk mbulon çdo veprim të motivuar nga feja. "Në një shoqëri demokratike ku bashkëjetojnë fe të ndryshme, kjo liri mund të kufizohet për të ruajtur harmoninë dhe respektin për besimet e të gjithë qytetarëve, duke theksuar rolin neutral dhe të paanshëm të

shtetit si garant i tolerancës fetare. Gjykata ka vënë në dukje se rregullat lidhur me bartjen e simboleve fetare në institucionet arsimore ndryshojnë nga vendi në vend, duke u bazuar në traditat kombëtare dhe nevojën për mbrojtjen e të drejtave dhe rendit publik", thuhet në komunikatë. Gjykata rikujton, po ashtu, se Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në shumë raste është përballur me ankesa që pretendonin se një individ i është nënshtuar trajtimit diskriminues në bazë të fesë apo besimit. Prandaj, Gjykata Supreme

vlerëson se ligjdhënësi, në mënyrë të tërthortë, por të qartë, ka përcaktuar kufizime të pranueshme në lidhje me veshjen e nxënësve, duke lënë në kompetencë të ministrisë përkatëse caktimin e këtyre rregullave nëpërmjet akteve nënligjore. Gjykata Supreme çmon se rregullat e miratuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, të cilat ndalojnë bartjen e çdo veshjeje tjetër përveç uniformës shkollore, janë në përputhje me ligjin dhe me kompetencën e deleguar ligjore dhe si të tilla nuk përbëjnë tejkalim të autorizimeve të dhëna nga ligjdhënësi.

## KRYETARI I AKB-së: MOSMIRATIMI I BUXHETIT MUND TA ÇOJË VENDIN DREJT FALIMENTIMIT

PRISHTINË, 29 TETOR - Kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB), Agim Shahini, thotë se që nga dita e parë ka qenë e ditur se qeveria nuk i ka votat e mjaftueshme. Shahini në një intervistë për "GazetaBlic" thotë se për këtë bllokadë politike fajtohet qeveria e vendit, e cila interesin personal dhe politik e ka vendosur para interesit të Kosovës. "Se qeveria nuk i ka votat është ditur nga dita e parë, se pse është bllokada, fajtohet qeveria, por se do të vijë bllokada tjetër prapë janë fajtorë udhëheqësit e Qeverisë së Kosovës, të cilët interesin personal dhe politik e kanë vënë para interesit të Kosovës", tha ai. Ndër të tjera, ai thotë se mosformimi i qeverisë do të ndikojë në ekonominë e vendit në aspektin financiar. Shahini tregon se humbjet të cilat i kanosen Kosovës, janë shumëdimensionale si në aspektin ekonomik ashtu edhe atë diplomatik. Ai thekson se këto humbje të mëdha janë dëmtrim i imazhit të shtetit dhe të ardhmërisë sonë. "Ndikimi



në ekonominë e vendit në aspektin financiar, dy vjet nën sanksione dhe një vit pa investime, qofshin ato publike apo të huaja, dhe mundësinë për të thithur kapital nga bankat e ndryshme botërore. Pra, ne kemi humbur dhe humbjet janë rreth dy miliardë

euro. Humbje faturohen, po ashtu, sanksionet ekonomike, mosgatishmëria e investitorëve dhe bankave të ndryshme për t'i mbështetur iniciativat e bizneseve në Kosovë dhe institucioneve shtetërore, mosratifikimi i marrëveshjeve të ndryshme

ndërkombëtare që kanë ndikim financiar. Prandaj e gjithë kjo ka bërë që Kosova më në fund të jetë edhe e përjashtuar nga dialogu strategjik me ShBA-në dhe kemi hyrë në një bllok me shtetet e lindjes", ka thënë ai. Shahini thotë se të gjitha këto

bllokada të njëpasnjëshme e dërgojnë Kosovën drejt falimentimit, ku shton se vendi tani po hyn në një fazë të re bllokuese. "Të gjitha këto bllokada të njëpasnjëshme çojnë drejt falimentimit të shtetit, sepse nëse nuk e kemi buxhetin e miratuar për vitin e ardhshëm, ne kemi të drejtën që deri në muajin shkurt në mënyrë të limituar të shpenzojmë shpenzime", ka thënë ai, duke shtuar se po të ishte Kuvendi i konstituuar përmes një vendimi shpenzimet ishin vazhduar edhe për një muaj tjetër. "Por sipas kësaj që po shohim, duket se nuk do të kemi zhbllokim, por vetëm po hyjmë në fazë të re bllokuese. Faza e re bllokuese po sjell vit të rëndë tjetër ekonomik 2026, që do të ballafaqohemi edhe me turrje ekonomike, me ikje të rinjve dhe rritje të varfërisë në Kosovë", ka theksuar ai. Shahini ka thënë se në këtë situatë të cilën ndodhemi ka rrezik për falimentim të bizneseve, por edhe falimentim të vet shtetit pa buxhet.

## Hapet një kapitull i ri për të rinjtë dhe të ardhmen digjitale të Prishtinës

PRISHTINË, 29 TETOR - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me IPKO Foundation/Dokutech për ta kthyer kryeqytetin në qendrën

e inovacionit, teknologjisë dhe Inteligjencës Artificiale në rajon. “Nga laboratorë STEAM, trajnime në AI, te festivali ndërkombëtar DOKUTECH që rikthehet në

Pallatin e Rinisë. Ky është një investim i fuqishëm në rininë tonë dhe të ardhmen e qytetit. Prishtina po rritet si qytet i dijes, inovacionit dhe mundësive!”, ka njoftuar

komuna e Prishtinës, duke theksuar se me këtë marrëveshje hapet një kapitull i ri për të rinjtë dhe të ardhmen digjitale të Prishtinës.



## SUPREMJA SHFUQIZON NENIN QË KUFIZONTE TË DREJTËN E VETERANËVE TË UÇK-së PËR PËRFITIMIN E PENSIONIT

PRISHTINË, 29 TETOR - Gjykata Supreme e Kosovës ka shfuqizuar një nen të një udhëzimi administrativ i cili u kërkonte veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të paraqisnin dëshmi se nuk ishin në marrëdhënie pune për të përfituar nga pensioni. Udhëzimi Administrativ nr. 01/2025 i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) kishte vendosur si kusht që veteranët, për të përfituar kompensim financiar, duhet të dëshmonin me dokument nga Administrata Tatimore e Kosovës se nuk janë të punësuar. Gjykata Supreme ka vendosur se ky kusht është i paligjshëm, sepse ligji në fuqi, neni 16A, paragrafi 5, nuk ua ndalon veteranëve që janë të punësuar në sektorin privat të përfitojnë nga pensioni. Sipas ligjit, vetëm ata që janë të punësuar në institucione publike ose ndërmarrje publike, pra që paguhen nga buxheti i shtetit, përjashtohen nga përfitimi. Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së, e cila e kishte paditur Ministrinë për këtë udhëzim, e përshëndet vendimin e Supremes në një shkrim në “Facebook”. “Ky vendim është një fitore e drejtësisë dhe e ligjit, sepse rikthen në vend një padrejtësi të bërë ndaj shumë veteranëve

që, pavarësisht se janë të punësuar në sektorin privat, u ishin mohuar të drejtat ligjore të përfitimit nga skema e kompensimeve”, tha kjo organizatë. Supremja tha se gjatë shqyrtimit të Ligjit për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre, ka vlerësuar se me ndryshimet dhe plotësimet e fundit të ligjit është krijuar një “paqartësi dhe konfuzion juridik” në lidhje me ekzistimin ose jo të marrëdhënies së punës si kriter për përfitimin e së drejtës ligjore të kompensimit financiar. “Në këtë drejtim Gjykata ka interpretuar nenin 16A, paragrafin 5 të ligjit të ndryshuar, i cili përcakton se: Veteranët e luftës së UÇK-së që punojnë jashtë institucioneve që paguhen nga buxheti i Kosovës, si dhe jashtë ndërmarrjeve publike, do të gëzojnë njëtrajtshëm deri në 50 % të shumës së paraparë, por që në total nuk do të kalojë 0.7 % të Bruto Prodhimit Vendor”, thuhet në vendim. Gjykata vendosi se e drejta për përfitim nga kjo kategori ligjore nuk varet nga ekzistenca e marrëdhënies së punës në përgjithësi, por nga natyra e punëdhënësit dhe burimi i



financimit të pagës, pra nëse ai burim është apo jo buxheti i shtetit. Ajo i kërkoi Ministrisë ta shfuqizojë ose harmonizojë me përmbajtjen e ligjit të ndryshuar të vitit 2017 udhëzimin administrativ të vitit 2015 në lidhje me kushtin që një veteran të mos jetë në marrëdhënie pune për përfitimin e kompensimit.

Veteranët e luftës së viteve 1998-1999 në Kosovë, të cilët janë të papunësuar, marrin pension mujor që nga viti 2015. Sipas të dhënave shtetërore, nga rreth 46 mijë veteranë të regjistruar, rreth 37 mijë përfitojnë një pension prej 204 eurosh. Sipas Ligjit për Veteranët e Luftës së UÇK-së, ekzistojnë

gjashtë kategori veteranësh: invalidi i luftës, veterani luftëtar, i internuari, pjesëtari, pjesëmarrësi i luftës dhe ushtari i zhdukur i UÇK-së. Po sipas të njëjtit ligj, vetëm ata që e kanë statusin e veteranit luftëtar të UÇK-së kanë të drejtë në pension dhe përfitime shtesë, ndërsa kategoritë e tjera vetëm në përfitime të parapara me ligj.

## KAPACITETET E FSK-së NË FOKUS TË TAKIMIT MES MAQEDONCIT DHE RUDOLPH



PRISHTINË, 29 TETOR - Ministri në detyrë i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka pritur të mërkurën në takim ambasadorin e Republikës Federale të Gjermanisë, Rainer Rudolph. Në këtë takim ministri Maqedonci diskutoi për situatën e sigurisë në vend, stabilitetin dhe sfidat e vendit

dhe rajonit në një periudhë që është sfiduese për sigurinë, si dhe e informoi ambasadorin Rudolph për kapacitetet aktuale të Forcave të Sigurisë së Kosovës. Ministri Maqedonci duke shprehur mirënjohjen për mbështetjen e gjatë të shtetit gjerman ndaj Republikës së

Kosovës, praninë e shtuar të trupave gjermane në kuadër të KFOR-it, theksoi dhe besimin që ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe me ambasadorin Rudolph në drejtim të thellimit të bashkëpunimit ndërmjet të dy shteteve në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

### Oficeri i FSK-së diplomon në ShBA

PRISHTINË, 29 TETOR - Toger Florent Korrani ka diplomuar në trajnimin bazik për Inxhinieri Ushtarake në Fort Leonard

Wood të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Trajnimi ka për fokus përgatitjen e liderëve të rinj për planifikim, udhëheqje

dhe drejtim të operacioneve të inxhinierisë ushtarake. Toger Korrani është shpërblyer me certifikatë

për arritje akademike të dalluar (Honor Graduate) e cila u jepet ushtarakëve që arrijnë rezultate të larta në akademi gjatë trajnimit.



# ODA AMERIKANE DISKUTON ME DREJTUESIT E INSTITUCIONEVE KYÇE TË DREJTËSISË PËR FUQIZIMIN E SUNDIMIT TË LIGJIT

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 29 TETOR - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë zhvilloi një takim me ushtruesin e detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi dhe kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Albert Zogaj, për të diskutuar për përpjekjet e vazhdueshme për forcimin e sundimit të ligjit dhe garantimin e sigurisë juridike për investitorët. Të dy zyrtarët ndanë perspektiva të vlefshme mbi transparencën gjyqësore, zgjidhjen e drejtë dhe të shpejtë të rasteve, si dhe luftimin e korrupsionit në sektorin publik dhe privat. Ata rikonfirmuan përkushtimin e tyre për vazhdimin e dialogut me Odën Amerikane përmes kanaleve formale të komunikimit dhe i inkurajuan bizneset t'i përdorin mekanizmat zyrtarë për adresimin e shqetësimeve dhe

raportimin e rasteve.

Drejtori ekzekutiv i Odës Amerikane, Arian Zeka, theksoi se Oda Amerikane ka qenë dhe mbetet një promovuese e vazhdueshme e sundimit të ligjit si gur themeli për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe klimë të besueshme investimi. Ndërkaq, Korab Sejdiu, kryesues i Komitetit të Shërbimeve Financiare dhe Klimës Investuese të Odës Amerikane, nënvizoi rëndësinë e trajtimit të rasteve specifike që kërkojnë vëmendjen e institucioneve të drejtësisë për ndërtimin e një besimi më të madh në sistemin.

Gjatë takimit u vlerësua edhe përparimi i arritur ndër vite nga institucionet e drejtësisë në Kosovë, si një hap pozitiv drejt forcimit të llogaridhënies dhe rritjes së besimit të komunitetit të biznesit.

Gjatë diskutimit përfaqësuesit e sektorit privat shprehën



shqetësimet e tyre lidhur me aspekte të ndryshme të funksionimit të sistemit të drejtësisë dhe ndikimin e tij në mjedisin e biznesit.

Oda Amerikane rikonfirmoi gatishmërinë e saj për të

mbështetur nisma që synojnë forcimin e sundimit të ligjit, promovimin e llogaridhënies dhe garantimin e pavarësisë së institucioneve të drejtësisë në vend.

Gjatë takimit u vlerësua edhe

përparimi i arritur ndër vite nga institucionet e drejtësisë në Kosovë, si një nxitje për vazhdimin e përparimit në forcimin e sundimit të ligjit dhe ndërtimin e besimit të komunitetit të biznesit.

## GUVERNATORI ISMAILI THEKSON ANGAZHIMIN E BQK-SË PËR MODERNIZIMIN E SISTEMIT TË PAGESAVE NË KOSOVË

PRISHTINË, 29 TETOR - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, ishte folës në Konferencën e 16 Ndërkombëtare mbi Pagesat dhe Infrastrukturat e Tregut, me temën "Rikrijimi i pagesave për epokën digjitale", organizuar në Ohër nga Banka Kombëtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut (NBRM) dhe Banka Qendrore e Holandës (DeNederlandsche Bank). Fokusi i konferencës ishte diskutimi mbi forcimin e kuadrit financiar drejt integritimit në Zonën e Vetme të Pagesave në Euro (SEPA) përmes lidhjes së infrastrukturës së pagesave të Ballkanit Perëndimor me atë të Bashkimit Evropian. Gjatë fjalës së tij në panelin "Realizimi i SEPA-s para anëtarësimit në BE: Përafrimi i infrastrukturës, rregulloreve dhe inovacionit" me pjesëmarrjen e guvernatorëve të rajonit dhe përfaqësuesve të Bankës



Botërore, guvernatori Ismaili nënvizoi angazhimin e BQK-së për modernizimin e sistemit të pagesave në Kosovë, forcimin e infrastrukturës financiare dhe përgatitjen për integrim të plotë në SEPA, si pjesë e procesit të afrimit me standardet e Bashkimit Evropian.

Duke u ndalur në aspektin teknik dhe të tregut, guvernatori

Ismaili theksoi se bankat dhe institucionet financiare në Kosovë tashmë zbatojnë formatin IBAN si dhe përdorin standardin ISO 20022 nga implementimi i RTGS. Ai shtoi se përfitimi më i madh tashmë i dukshëm në rajon dhe në Kosovë lidhet me hapjen e tregut për aktorë të rinj FinTech në fushën e pagesave, çka ka nxitur rritjen e

konkurrencës dhe interesit për inovacion.

Megjithatë, guvernatori Ismaili theksoi se sfida mbetet siguri i përpunimit të plotë operacionale me direktivat PSD2 dhe PSD3, forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (AML/CFT), si dhe

garantimi që industria e pagesave të jetë në përputhje me standardet evropiane.

Duke folur për modernizimin e mëtejshëm të infrastrukturës së pagesave, guvernatori Ismaili bëri me dije se BQK-ja ka integruar procesin e SEPA-s në një strategji më të gjerë të transformimit të pagesave. Ai nënvizoi se projekti TIPS Clone përbën shtyllën teknologjike të kësaj strategjie, e cila do të mundësojë pagesa të menjëhershme në nivel kombëtar dhe ndërkufitar me vendet e rajonit dhe të Bashkimit Evropian.

Duke falënderuar organizatorët për këtë konferencë të rëndësishme, guvernatori Ismaili vlerësoi bashkëpunimin e shkëlqyer me bankat qendrore dhe autoritetet rregullatore të rajonit dhe të Bashkimit Evropian, si dhe kontributin e institucioneve ndërkombëtare në përkrahje të modernizimit të sistemit të pagesave të Kosovës.

## Konsumi i energjisë elektrike është rritur 18.5 % në tetor

PRISHTINË, 29 TETOR - KEDS-i ka njoftuar se gjatë gjithë muajit tetor konsumi i energjisë elektrike ka qenë dukshëm më i lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Deri më 27 tetor qytetarët në mbarë vendin kanë

konsumuar 18.5 % më shumë energji, sipas të dhënave nga matjet në rrjet.

Arsyeja kryesore për këtë rritje është përdorimi masiv i energjisë elektrike për ngrohje. "Kërkesa më e lartë sesa kapacitetet e rrjetit po shkakton mbingarkesa,

sidomos në orët e ngarkesës së lartë. Prandaj, apel për përdorim racional dhe të kujdesshëm të energjisë, në mënyrë që të zvogëlohet presioni mbi rrjet dhe të sigurohet furnizim i qëndrueshëm për të gjithë", ka njoftuar KEDS-i.



# MAKIAVELIZMI. KUR POLITIKA NDAHET NGA MORALI



Nëse ka patur një personazh që tronditi mënyrën se si njerëzit e kuptojnë pushtetin, ai ka qenë Niccolò Machiavelli. I lindur në Firence më 1469, në një kohë kur Italia jetonte mes luftërash, tradhtish dhe aleancash të përkohshme, Makiaveli u bë dëshmitari më i mprehtë i realitetit brutal të politikës. Dhe kur më në fund u përjashtua prej saj, bëri atë që dinte më mirë: e ktheu përvojën në ide.

Kështu lindi Princi – libri që ndryshoi përgjithmonë mënyrën se si njerëzimi mendon për pushtetin.

## Diplomati që u përjashtua

Për më shumë se një dekadë, Makiaveli shërbeu si sekretar dhe diplomat i Republikës së Firences. Ai udhëtoi në oborret e Francës, Papës dhe princërve italianë, duke parë nga afër se si sunduesit ruanin pushtetin jo përmes virtytit, por përmes forcës, mashtrimit dhe aftësisë për t'u përshtatur.

Kur familja Medici u rikthye në pushtet më 1512, fati i tij u përmbys. U arrestua, u tortu-

rua dhe më pas u la i lirë – i thyer dhe tashmë pa poste. Ishte në këtë vetmi që ai shkroi Princin, një libër që nuk kërkonte të ishte moral, por i vërtetë.

## Libri që tronditi botën

Në një epokë kur filozofët flisnin për drejtësi, virtyt e mirësi, Makiaveli guxoi të thoshte diçka ndryshe: “Rëndësi ka jo të dukesh i mirë, por të jesh efektiv.”

Në thelb, Princi ishte një udhëzues për mbijetesën e një sundimtari në një botë të pamëshirshme.

Për Makiavelin, pushteti nuk ruhet me moral, por me aftësi për ta kuptuar njeriun ashtu siç është – egoist, i frikësuar dhe i ndryshueshëm. Ai e ndau politikën nga morali dhe vendosi një standard të ri: efektivitetin.

Kjo ishte herezi në shekullin XVI. Një herezi që s'u harrua kurrë më.

## Virtyti që s'ka të bëjë me mirësinë

Tek “Princin”, një nga konceptet më intriguese është ai

i virtutit. Por virtyti i Makiavelit nuk ka të bëjë me virtytin moral – ai është aftësia për të vepruar me forcë, zgjuarsi dhe kurajo. Është zotësia për t'i bërë gjërat të ndodhin, pavarësisht rrethanave.

Kundër virtutit qëndron fortuna – fati, forca e paparashikueshme që mund të shkatërrojë çdo plan. Por, sipas Makiavelit, sundimtari i zgjuar nuk pret që fati ta shpëtojë. Ai ndërton diga, siç ndërtohen për të përballuar përmbytjet. Fati është lumë, por njeriu mund ta drejtojë rrjedhën e tij.

## Më mirë të të duan, apo të të kenë frikën?

Kjo është ndoshta pyetja më e famshme e Makiavelit: “A është më mirë që sundimtarin ta duan, apo t'i tremben?”

Përgjigjja e tij është e thjeshtë dhe brutale: më mirë të të kenë frikën. Dashuria është e paqëndrueshme, ndërsa frika është e qëndrueshme – për sa kohë nuk kthehet në urrejtje. Një sundimtar, shkruan ai, duhet të dijë të përdorë frikën me maturi: aq sa për të

ruajtur respektin dhe rendin, por jo sa për t'u bërë i urryer. Në këtë balancë delikate qëndron arti i pushtetit.

Makiaveli e njihte mirë natyrën njerëzore. Ai e dinte se njerëzit nuk gjykojnë sipas të vërtetave, por sipas dukjeve. Kështu, një sundimtar duhet të duket i mëshirshëm, i drejtë, bujar – edhe kur nuk është. Sepse pushteti, si çdo art tjetër, kërkon mjeshtëri në krijimin e iluzioneve.

Në këtë sens, Princi është më shumë se një traktat politik. Është një manual mbi perceptimin, mbi psikologjinë e turmës dhe mbi teatrin e pushtetit.

## Pushteti dhe realiteti

Në thelb, Makiaveli ishte realist. Ai nuk e urrente moralin, por e kuptonte kufirin e tij në një botë të egër. Ai e dinte se drejtësia dhe mëshira janë virtyte të bukura – por të padobishme kur një sundimtar nuk arrin të mbrojë shtetin e vet.

Ai shkroi në një kohë kur Firence kërcënohej nga çdo anë, kur mbretërit e huaj ndërronin territore si letra bixhozi. Dhe në atë botë, ide-

alizmi ishte luks. Prandaj Princi nuk është një libër i pashpirt, por një pasqyrë e ftohtë e realitetit. Një udhëzues për mbijetesën në kohë kaosi.

## Trashëgimia e njeriut që tha të vërtetën

Makiaveli vdiq pa parë librin e tij të botuar. Por kur Princi doli në qarkullim më 1532, ai ndezi zjarrin e debatit në gjithë Evropën. U quajt “djalli i politikës”, “armiku i moralit”, “mësuesi i tiranëve”. Dhe megjithatë, asnjë nga akuzat nuk e ndaloi dot ndikimin e tij.

Nga Napoleoni te Hobbes-i, nga Nietzsche te liderët modernë, të gjithë kanë lexuar Makiavelin për të kuptuar një të vërtetë të thjeshtë: pushteti është një art që kërkon guxim, mençuri dhe një njohje të thellë të natyrës njerëzore.

Pesë shekuj më vonë, Princi mbetet një pasqyrë e ndershme e asaj që shpesh refuzojmë të pranojmë: se politika, në fund, nuk është për engjëj, por për ata që dinë të përballen me realitetin ashtu siç është. / bota.al

# JU KANË ZBULUAR! SINDROMA E TË SHTIRURIT

A jeni ndier ndonjëherë sikur jeni të shtirur, që vetëm bëni “bllof”? Dakord, s’jeni vetëm. Edhe mendjet më brilante të botës kanë frikë se mos “zbulo-hen”. Po cili është shkaku i sindromës së të shtirurit (Impostor Syndrome)? Dhe a mund të kalohet?

A jeni ndier ndonjëherë sikur shtireni? Kur keni marrë një punë të re ose një promovim, a keni menduar se s’jeni mjaftueshëm të mirë dhe se, me siguri, dikush do t’ju demaskonte? Nëse po, ka shumë gjasa të përjetoni sindromën e të shtirurit. Dhe, sigurisht, s’jeni të vetmit. Disa studime tregojnë se 70–80% e popullsisë botërore e ka përjetuar këtë gjendje në një moment të jetës... përfshirë disa nga njerëzit më inteligjentë në histori. Pak para se të vdiste, Albert Ajnshtajni i tha një miku se lavdet për studimet e tij e bënin të ndihet si një mashtrues i pavetëdijshëm. Duke parë këto të dhëna, është befasuese se si “fenomeni i të shtirurit”, siç quhej fillimisht – “një përvojë e brendshme e falsitetit intelektual” – me kalimin e viteve është bërë shumë më kompleks. Valerie Young, eksperte e sindromës së të shtirurit dhe bashkëthemeluese e Impostor Syndrome Institute, e përkufizon si: “bindja, e vetëdijshme ose e pavetëdijshme, se nuk jemi aq inteligjentë, të aftë, të sigurt në vete e të talentuar sa na shohin të tjerët; një bindje që vazhdon pavarësisht provave konkrete të suksesit apo aftësive, dhe që na shtyn të kemi frikë se mos zbulohemi”.

Përveç punës së Young dhe ekspertëve të tjerë, edhe shumë personazhe publikë e kanë sjellë këtë gjendje në vëmendje: nga Michelle Obama te Natalie Portman, nga Kamala Harris te Tom Hanks, janë gjithnjë e më shumë ata që rrëfejnë se ndihen “të papërshtatshëm” për rolin e tyre. Megjithë këtë vëmendje, vazhdojnë të qarkullojnë bindje të gabuara ose sipërfaqësore. Së pari: për të qenë të saktë, nuk është as “sindromë”. “Nuk është një gjendje e diagnostikueshme mjekësisht apo psikologjike”, thekson Young. Më shumë sesa çrregullim, është një përvojë ose model përvojash ku njerëzit mund ta gjejnë veten: pamundësia për të marrë meritat e sukseseve, prirja për perfeksionizëm të paarritshëm, mohim i aftësive vetjake dhe një frikë e thellë nga dështimi (atiksofobi) ose edhe nga suksesi (nikefobi), që mund t’i bëjë të tjerët të presin më shumë prej nesh.

Ka gjasa që të mos ekzistojë as një tip i vetëm i sindromës. Psikologë në Universitetin Goethe të Frankfurtit dallojnë dy tipe kryesore: të shtirur të vërtetë dhe të shtirur

strategjikë. Të parët e përjetojnë realisht; të dytët luajnë rol: edhe pse e dinë mirë vlerën e tyre, paraqiten më pak të aftë për të menaxhuar pritshmëritë dhe për t’u dukur më të afërt. Me fjalë të tjera, me qëllime të mira, shtiren.

Në përgjithësi, sindroma është shumë më komplekse nga sa mendohej fillimisht. Duke studiuar shkaqet dhe zgjidhjet, kanë dalë në pah shumë informacione të dobishme (dhe shumë dezinformim).

## Pse shfaqet

Edhe pse mund të duket se buron vetëm nga mungesa e sigurisë, rrënjët e saj janë të ngatërruara. Shkaqet e sakta janë të vështira për t’u veçuar sepse është rast klasik i biologjisë kundër shoqërisë. Ka gjasa që gjenetika të luajë rol, por disa individë janë më të prirur ta zhvillojnë për shkak të kontekstit shoqëror ku jetojnë.

Edhe gjinia mund të jetë faktor, por jo aq sa mendohej. Studimet e para u përqendruan te studente ekselente që dyshonin se s’do kalonin provimet, ndaj sindroma u konsiderua problem vetëm femëror. Është e vërtetë se, sipas një meta-analize të 100 studimeve, gratë kanë më shumë gjasa të nënvlerësojnë aftësitë e veta. Megjithatë, diferenca mes burrave dhe grave është zakonisht “e lehtë deri mesatare”.

“Arsyet janë ende objekt debati,” thotë Jessamy Hibberd, psikologe klinike dhe autore e The Imposter Cure. Sipas saj, këto arsye janë kryesisht sistemike dhe lidhen me faktin që gratë hynë më vonë në tregun e punës. “Të gjithë kemi ende paragjykime të brendshme për rolin e grave në punë, dhe kjo ndikon në bindjet tona,” shton ajo.

Në të njëjtën mënyrë, edhe etnia mund të jetë përcaktuese. Kevin Cokley, profesor i psikologjisë në Universitetin e Miçiganit, thotë: “Siç mund të merret me mend, diskriminimi ndaj disa pakicave mund ta amplifikojë bindjen te anëtarët e tyre se nuk e meritojnë atë që kanë arritur”.

Edhe mjedisi i punës bën diferencë. Sipas Young, nëse punoni në sektorë me dendësi të lartë informacioni, ku kërkohet njohuri e pagabueshme në tema që ndryshojnë vazhdimisht, rreziku për të zhvilluar këtë gjendje rritet. Prandaj është mjaft e zakonshme te mjekësia, STEM (shkencë, teknologji, inxhinieri, matematikë) dhe akademia, sidomos te studentët.

Një studim te të diplomuarit e Universitetit të Vjenës gjeti se gati 8 në 10 pjesëmarrës e përjetonin sindromën shpesh ose në mënyrë mesatare, ndërsa



12,6% e përjetonin në mënyrë intensive.

Edhe mjedisi familjar ka rëndësi. Siç tregon kërkimi origjinal për sindromën e të shtirurit: nëse jeni rritur në një familje ku nuk ju komplimentonin për inteligjencën, por për gjëra të tjera (pamjen, aftësitë shoqërore), mund të zhvillonin ndjenja të shtiruri pikërisht ndaj inteligjencës suaj. Nga ana tjetër, nëse gjithmonë ju lavdëronin si “të zgjuar”, mund të vuani për t’u treguar në lartësinë e atyre pritshmërive.

Nëse asgjë nga këto s’e shpjegon plotësisht përvojën tuaj, mund t’ju tërheqë perspektiva evolucionare. Psikologë në Universitetin e Athinës kanë hamendësuar se nënvlerësimi i aftësive mund të ketë shërbyer si mekanizëm shtytës për t’u përpjekur më shumë. Por ndërsa kjo mund të ketë ndihmuar mijëra vjet më parë, sot është shumë më pak e dobishme për punën e përditshme në zyrë.

## Zgjidhja: faktet, jo ndjenjat

Le ta pranojmë: sindroma s’ka shumë kuptim. Të ndierit të papërshtatshëm është, në fund, produkt i këndvështrimit tonë dhe shpesh bazohet në arsyetime kontradiktore. “Shumë njerëz ndjekin dy rregulla bazë,” shpjegon Hibberd: “Nëse gjithçka shkon mirë, suksesin ia atribuojnë faktorëve të jashtëm; nëse shkon keq, faji është personal”. Dalja nga ky mendim nënkupton të përqendrohemi te faktet, jo te ndjenjat. Si? Young, Hibberd dhe Cokley pajtohen: duhet gjetur një sistem për të regjistruar sukseset reale. Kjo është strategjia nr. 1, sipas Cokley: “Njerëzit që e përjetojnë këtë gjendje nuk u kushtojnë vëmendje momenteve të suksesit. Duhet të merrni kohë për t’i njohur sukseset. Unë këshilloj t’i shkruani rregull-

isht dhe ta rishikoni listën herë pas here.”

## Zbuloni “sekretin”

Nuk jeni vetëm. Po, tingëllon e thjeshtë dhe klishe, por mund t’ju ndihmojë të ndryshoni ndjenjën e pamjaftueshmërisë. Siç thotë Young: nëse ka kaq shumë njerëz që e përjetojnë, ka gjasa që problemi të jetë mjedisi, jo individët. Ajo sjell shembullin e një takimi me studentë mjekësie në një ambient konkurrues: të kup-tuarit dhe pranimit se punonin në një kontekst që ushqen lehtësisht ndjenjat e të shtirurit u bë mekanizëm mbrojtës. “Kjo vetëdije i lejoj të internalizojnë më pak dhe të kontekstualizojnë më shumë,” thotë Young.

Po ashtu, këto ndjenja shpesh shoqërohen nga fshehtësi dhe turp. Nëse s’ndihemi mjaftueshëm të mirë, nuk do ta themi vërdallë – sidomos para atyre që duken shumë të suksesshëm. Por ky sekret na izolon, duke i përforcuar bindjet. “Shpesh njerëzit vuajnë në heshtje, sidomos në mjedise konkurruese,” thotë Cokley. “S’jemi të gatshëm t’u tregojmë të tjerëve dobësitë tona, që të mos u japim përparësi. Por ka gjasa që, nëse po vuani ju, po vuajnë edhe kolegët. Të flisni me dikë në vendin e punës mund t’ju ndihmojë të normalizoni emocionet.”

## Angazhohuni të “dështoni”

Një nga mënyrat më të mira për ta kapërcyer këtë gjendje është... të mos bëni perfeksionistin. Madje, të gabosh me qëllim mund të ndihmojë. Sipas Hibberd, sindroma ju shtyn të punoni tepër ose të zvarrisni realizimin e detyrave. Sepse prirëni të vendosni standarde shumë të larta: “E ngremë vazhdimisht stekën; duam diçka dhe, sapo e arrijmë, kalojmë te hapi tjetër”,

thotë ajo. Nëse e shihni veten kështu, e keni të vështirë të shihni objektivisht sukseset – ose t’i pranoni. Kjo çon ose në punë të tepërt (që gjithçka të jetë perfekte), ose në zvarritje (nga frika se s’do dalë mjaftueshëm mirë).

Për ta kundërshtuar, Hibberd sugjeron të provoni të lini diçka të papërkryer dhe të shihni a e zbut kjo ndjesinë e “të shtirurit”: “Në vend që ta përfundoni një projekt në perfeksion ose të mos e dorëzoni fare, dërgoni një punë jo perfekte dhe vëreni nëse dikush e vë re.”

## Ndalo së menduari sikur shtiresh

Ju ka ndodhur të mos jeni më elokuenti në një takim? Jo më i forti në palestër? Të jeni i dobët në një lojë shoqërore? Sipas Young, është ok. Një keqkuptim i madh është se ekzistojnë vetëm dy tipe njerëzish: ata që ndihen të shtirur dhe ata me vetëbesim të pakufishëm që kurrë s’e ndiejnë veten si mashtrues. Kjo mënyrë mendimi përjash-ton mesataren.

Young propozon një opsion të tretë: realizëm i përlur. Nëse s’doni të ndiheni të shtirur, mos hyni në çdo situatë duke menduar se gjithçka do të shkojë në mënyrë të përsosur. Realistët e përlur e dinë se s’mund të shkëlqejnë gjithmonë e në çdo gjë – dhe nuk e kanë problem këtë. Ata njohin si pikat e forta, ashtu edhe të dobëta – dhe i pranojnë.

Sipas Young, vetëm duke e riformuluar sindromën në këtë pikëvështrim, mund të ndaloni së provuari disa nga këto ndjenja. Ky qasje ju ndihmon të ulni ndjeshëm kohën që kaloni duke u ndier të papërshtatshëm. Siç thotë ajo: “Mund të jesh i shtirur për një ditë, por jo për gjithë jetën.”

Elizabeth BENNETT / BBC  
Science – Bota.al



## PRISHTINA BIE NË LLAP, FITOJNË DRENICA DHE FERIZAJ

**PRISHTINË, 29 TETOR** - Llapi i ka dhënë fund serisë pozitive të Prishtinës, pasi në xhiron e 11-t të Superligës ka ndalur hovin e ekipit nga kryeqyteti. Të mërkurën në stadiumin “Zahir Pajaziti” në Podujevë, Llapi ka fituar derbin e kësaj xhiroje me shifrat 2:1. Një gol në pjesën e parë dhe një tjetër

në të dytën nga Edon Sadriu, përkatësisht Alex Gnapi për Llapin ndalën serinë prej gjashtë fitoreve rresht të Prishtinës, ekip për të cilin realizoi Kryeziu. Për Prishtinën kjo është humbja e dytë këtë sezon, ndërsa e para që nga data 31 gusht kur në kuadër të xhiros së tretë pati pësuar nga

Gjilani 3:1. Përkundër humbjes, Prishtina mbetet në krye të tabelës me 25 pikë, 9 më shumë se Llapi që mbetet i pesti dhe regjistroi fitoren e katërt në pesë ndeshjet e fundit. Fitore në shtëpi ka shënuar edhe Drenica për t'i dhënë fund serisë prej katër

humbjeve rresht. Skuadra nga Skenderaj triumfoi 3:1 ndaj kampiones në fuqi, Dritës, që regjistroi humbjen e katërt këtë sezon. Ndërkohë, Ferizaj ka fituar 3:0 ndaj Prishtinës së Re, ekip që nuk di për fitore prej xhiros së katërt dhe mbetet e fundit në tabelë me 7 pikë.



## GRANIT XHAKA, ‘MOTORI’ I PREMIERË LIGËS, SHQIPTARI ËSHTË LOJTARI QË KA VRAPUAR MË SHUMË DERI TANI



**LONDËR, 29 TETOR** - Mesfushori shqiptar i Sunderlandit, Granit Xhaka, po përjeton një fillim sezoni magjik me “Macet e Zeza” në Premierë Ligë. Xhaka i ka befasuar të gjithë kur vendosi gjatë verës të transferohet nga Bayer Leverkuseni te Sunderlandi, por zgjedhja e tij ka rezultuar të jetë e suksesshme.

Sunderlandi ka qenë befasia më e madhe deri tani këtë edicion pasi në nëntë ndeshje ka mbledhur plot 17 pikë, duke zënë pozitën e katërt. Një nga më meritoret për këtë nisje të përkryer të edicionit padyshim se është shqiptar Xhaka, i cili si kapiten po udhëheq ekipin, teksa ka bërë edhe tri

asistime. Megjithatë, kjo nuk është arritje e vetme e Xhakës, pasi 33-vjeçari është futbollisti që ka vrapuar më së shumti kilometra në kampionat në nëntë xhirot e para. Sipas një postimi nga faqja zyrtare e Premierë Ligës, Xhaka ka vrapuar plot 100.8 kilometra në nëntë ndeshje, duke pasur një

mesatare mbi 11 kilometra për ndeshje. Pas Xhakës në renditje është bashkëlojtari i tij, Noah Sadiki, me 100.1 km, ndërsa pas tyre vijnë Elliot Anderson (Nottingham) me 99.9 km, Daniel Munoz (Crystal Palace) me 99.2 km dhe Sander Berge (Fulham) me 98.5 km kompletton pesëshen.

## MURIQI: DUA TË PENSIONOHET TE MALLORCA DHE PASTAJ TË HAP BIZNESE NË KËTË VEND

**MALLORCA, 29 TETOR** - Sulmuesi i kombëtares së Kosovës dhe Mallorcas, Vedat Muriqi, ka nisur sezonin shumë mirë, duke shënuar pesë gola në 10 ndeshjet e para. Muriqi, i cili ka qenë i ftuar në emisionin “Jugam a Fora de Joc”, ka thënë se qëllimi i tij është të bëhet golashënuesi më i mirë në historinë e klubit spanjoll. Kujtojmë se ai është gjashtë gola pas Arangos, ndërsa golashënuesi kryesor është Samuel Eto'o. “Kam rinovuar kontratën me Mallorcan dhe plani im është ta përfundoj këtu dhe të tërhiqem. Kur të tërhiqem, shpresoj të hap biznese në Mallorca dhe të mund të vij këtu dhe të flas për

klubin dhe skuadrën”, ka thënë ai. Më tutje, ai ka bërë me dije se si ka ardhur deri te transferimi i tij te Mallorca, pasi nuk po kalonte fazë të mirë te Lazio. “Kur isha te Lazio më telefonoi Ortells, por unë refuzova ofertën. Pata shumë vështirësi në Itali dhe kur isha në formë fizike, Sarri nuk më kishte në planet e tij. Desha të shkoja huazim te një ekip italian, por reputacioni im ishte shumë i dobët. Ortells më telefonoi sërish dhe fillova të kërkoja referenca nga Mallorca dhe prita. Nuk solla familjen sepse mendova se do të ishte vetëm për katër muaj. Erdha për katër muaj dhe jemi këtu pothuajse pesë vite”, ka shtuar

“Pirati” dardan. Ai ka thënë me plot vetëbesim se do ta ndjekë rekordin e Eto'os. “Do të doja të bëhesha një legjendë e Mallorcas. Jam gjashtë gola larg për ta kaluar Arangon si golashënuesi i dytë më i mirë në La Liga. Mendoj se këtë vit do ta kaloj. Vitin e ardhshëm do të shkoj pas Samuel Eto's”, ka thënë Muriqi. Muriqi ka thënë se e dëshiron një titull me Mallorcan, për ta mbajtur si kujtim. “Dua të fitoj një titull me Mallorcan dhe pothuajse e arritëm dy vjet më parë me Copa del Rey, sepse La Liga është shumë e vështirë. Do të doja të fitoja një trofe dhe të mos harroja. Për mua do të ishte një ëndërr e bërë realitet”, ka




deklaruar sulmuesi dardan. Në këtë intervistë, Muriqi ka shpalosur objektivat e Mallorcas dhe të tij për këtë sezon. “Do të jemi seriozë për Kupën, të fitojmë raundin e parë dhe ta marrim hap pas hapi. Ashtu si bëmë dy vjet më parë, jemi të aftë dhe kemi skuadrën për ta bërë. Duhet të besojmë dhe ta tregojmë në fushë, jo vetëm me

fjalë”, ka shtuar Muriqi, duke shtuar se këtë vit ka punuar shumë fizikisht dhe mendërisht. “Gjithmonë kisha dëmtime në muskujt e pasmë dhe tani po punoj për parandalim para dhe pas stërvitjes. Kam vështirësi të fle pas ndeshjeve. Nuk më pëlqejnë tabletat. Natën e kaluar kam fjetur në orën 4:00 dhe u ngrita në 8:00 të mëngjesit”, ka thënë ai kur është pyetur për lëndimet e pësuar. Ai foli edhe për “problemet” e tij me kequshqimin. “Shumë më pëlqente çokollata. Haj dy qese pas ndeshjeve. Kam qenë më i kontrolluar për dy vjet. Po ashtu, pija shumë 'Coca-Cola', e tani nuk e kam pirë për shtatë muaj”, ka përfunduar Muriqi.

## SKANDAL NË FUTBOLLIN ITALIAN, GJYQ TARË TË KORRUPTUAR PËR T'I KURDISUR NDESHJET, ZBULOHEN PËRFITIMET MILIONËSHE

**ROMË, 29 TETOR** - Një rrjet i sofistikuar manipulimi rezultatesh është zbuluar nga autoritetet italiane, duke përfshirë gjyqtarë, sipërmarrës dhe bastvënës. Skema, e quajtur nga hetuesit “Operacioni Penalty”, përfshinte ndikimin e ndeshjeve përmes korrupsionit të arbitrit dhe kontrollit të rezultateve për të përfutur nga bastet sportive. Sistemi ishte po aq i thjeshtë sa edhe efektiv. Një gjyqtar nga seksioni i Reggio Calabrias kontaktonte kolegët e tij në liga të ndryshme, duke i korruptuar me shuma deri në 10

mijë euro për çdo ndeshje të manipuluar. Në fushë, këta gjyqtarë siguronin që ndeshjet të përfundonin me një numër të caktuar golash, duke favorizuar bastet e tipit “Over”. Fitimet më pas ndaheshin ndërmjet tyre dhe rrjetit të basteve. Skema do të kishte vazhduar për një kohë të pacaktuar nëse nuk do të ishte vërejtur një fluks anormal bastesh në një ndeshje të kampionatit Primavera. Ky aktivitet i dyshimtë tërhoqi vëmendjen e Agjencisë së Doganave dhe Monopoleve, e cila sinjalizoi menjëherë



Prokurorinë e Reggio Calabrias. Pas raportimit, nisi një hetim i gjerë penal, që çoi në identifikimin e rrjetit të përfshirë. Në orët e para të mëngjesit të sotëm, karabinierët dhe Guardia

di Finanza ekzekutuan urdhra arresti shtëpiak ndaj pesë personave, të akuzuar për komplot për mashtrim sportiv. Në qendër të hetimit ndodhet një gjyqtar që vepronte në kampionatet Primavera, Primavera 2 dhe Seria C. Pavarësisht se më parë ishte pezulluar nga drejtësia sportive, ai arriti të rekrutonte arbitra të tjerë që jepnin penalizime të padrejta ose kartonë të kuq, duke ndikuar në rezultatin e ndeshjeve. Sipas hetimeve, rrjeti është financuar nga dy sipërmarrës

toskanë, baba e bir, pronarë të një pike bastesh në Sesto Fiorentino, të cilët janë tashmë në arrest. Ata përdornin platforma të huaja të paaautorizuara për të vendosur baste mbi ndeshjet e manipuluar, duke siguruar fitime të konsiderueshme. Autoritetet po vijnë hetimet për të përcaktuar nëse rrjeti kishte lidhje me struktura më të gjera të manipulimit të basteve. Ndërkohë, Federata Italiane e Futbollit (FIGC) pritet të nisë një proces paralel disiplinor ndaj gjyqtarëve të përfshirë.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada-Government  
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT  
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR  
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE  
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 1877/1  
Dt: 29.10.2025

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit 35 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës, nenit 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, neni 81 i Ligjit për Zyrtar Publik Nr. 08/L-197, Udhëzimit Administrativ 14/2014, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2015, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012, Rregullores (Qrk) Nr: 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instrukturëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

| Niveli | Institucioni/<br>Shkolla                                     | Vendi     | Pozita:                                                        | Vend i lirë/<br>Zëvendësim | Numri i<br>pozitave | Koeficienti<br>i pagës |
|--------|--------------------------------------------------------------|-----------|----------------------------------------------------------------|----------------------------|---------------------|------------------------|
| ShML   | Qendra e<br>Kompetencës<br>“Kujtim<br>Krasniqi”<br>Malishevë | Malishevë | Instruktur/e<br>për<br>Ndërmarrësi                             | Vend i lirë                | 1                   | 6.8                    |
| ShML   | Qendra e<br>Kompetencës<br>“Kujtim<br>Krasniqi”<br>Malishevë | Malishevë | Instruktur/e<br>për<br>administratë<br>dhe shërbim të<br>zyrës | Vend i lirë                | 1                   | 6.8                    |

I. Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për këtë vend pune

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.

II. Në momentin e aplikimit, kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (merret në Qendrën e Kompetencës për të cilën është shpallur konkursi);
- Rezymeja personale (CV);
- Dokumenti personal (kopje të letërnjoftimit ose pasaportës);
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat të noterizuara);
- Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASHTI;
- Çertifikatat e trajnimeve;
- Çertifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
- Dëshminë se nuk është i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- Për instruktor me së paku 5 vite përvojë pune në profesion në ndërmarrje, biznese dhe institucione tjera (dëshmi të përvojës së punës: vërtetim ose kontratat e punës);
- Kandidatët që kanë përvojë pune dorëzojnë edhe portfolio profesionale me përmbledhjen e punës së tyre (Udhëzimi për përgatitjen e portofolies Profesionale merret në Qendrën e Kompetencës përkatëse me rastin e aplikimit).

III. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 04/L-032, Ligji Nr. 04/L-138) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHTI-it: UA Nr. 05/2015, si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

Kriteret e kualifikimit për Instruktur/e për Ndërmarrësi

- Bachelor
- instruktorët profesional me kualifikim: post-sekondar, arsim të mesëm të lartë

Kriteret e kualifikimit për Instruktur/e për administratë dhe shërbim të zyrës

- Bachelor
- instruktorët profesional me kualifikim: post-sekondar, arsim të mesëm të lartë

IV. Detyrat dhe Përgjegjësitë për Instruktur:

- Instruktori është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.

- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e teorisë dhe praktikës profesionale.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të praktikës profesionale dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

V. Vlerësimi i kandidatëve

- Vlerësimi i njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve bëhet përmes:
- Testit me shkrim, i cili përbënë 50% të vlerësimit të përgjithshëm dhe ka në total 100 pikë.
- Intervista me gojë, pjesë e së cilës është edhe vlerësimi i portfolios, përbënë 50% të vlerësimit të përgjithshëm.
- Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë mbledhen në shumën e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjedhjen në pozitat e lartpërmendura.
- Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test me shkrim dhe intervistë me gojë, si dhe orari i intervistave do të njoftohen me e-mail dhe përmes telefonit.
- Rezultatet përfundimtare të vlerësimit do tu dërgohen kandidatëve me e-mail, do të publikohen në tabelën e njoftimëve në shkollë dhe në <https://konkursi.rks-gov.net/>.

VI. Afati dhe mënyra e aplikimit

- Konkursi mbetet i hapur 30 ditë nga dita e shpalljes nga data 30.10.2025 deri me 28.11.2025.
- Aplikacioni merret dhe dorëzohet në Shkollën përkatëse;
- Dokumentet e pakompletuara si dhe ato pas afatit, nuk merren në shqyrtim;
- Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje, përveç diplomave të noterizuara;
- Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
- Kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit, e cila është e domosdoshme me rastin e shpalljes së rezultateve përkatëse;
- Anëtarët e komuniteteve jo shumicë dhe personat me afëtesi të kufizuar inkurajohen të aplikojnë në pozitat e shpallura në përputhje me kualifikimet përkatëse.

Vërejtje: Të gjitha aplikacionet e pakompletuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Gazmend Tahiraj shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore “Dy Dëshmorët” Sheremetaj Gjakovë.

Agnesa Shala shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme “Asllan Berisha” Rogovë.

Besart Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore “Kongresi i Manastirit” Demjan Gjakovë.

Lajmërohen aksionarët me të drejt vote që mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Aksionarëve do të mbahet me dat: 02.12.2025 ora 11:00, në objektin e drejtorisë të .N.H. “Dukagjini” SH.A. Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Rubina RFSH” SH.P.K. pronar Albana Bajrami me seli në Vushtrri, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811904946 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Rubina RFSH” D.O.O. Albana Bajrami Vuqitrn donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811904946 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Rubina RFSH” L.L.C. with owner Albana Bajrami with headquarters Vushtria, has come to the decision to quit its business: 811904946 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

